



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-12113  
Datë 08.06.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit numër 04/L-032 për Arsimin Para Universitar në Republikën e Kosovës, nenin 12 i Udhëzimit Administrativ (MASHT) numër 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publikë Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Smajl Haziri caktohet ushtrues detyre i drejtorit të SHFMU "Fan Noli" në Dujakë nga data **28.06.2023** deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit për zgjedhjen e Drejtorit të ri;
2. Caktimi i kryesit të detyrës së Drejtorit është i përkohshëm ngase procedura e rekrutimit do të zhvillohet sipas rregullave ligjore përkatëse;
3. Autorizohet shërbimi financiar në kuadër të Drejtorisë për Arsim që të vazhdoj pagesën e të ardhurave personale në lartësi të koeficientit të paraparë për pozitën e Drejtorit të SHFMU;
4. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 15 ditësh, prej ditës së pranimit të te njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

**Vendimi iu dorëzohet:** Z. Smajl Haziri, Drejtorisë për Arsim, Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit.



**Kryetar i Komunës së Gjakovës**